



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

## **KUVENDI I KOMUNËS PEJË**

**- Komiteti Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit.-**

**Numër:01-060/01-34608**

**Pejë, datë: 16. Maj 2024.**

### **PROCESVERBAL**

Nga takimi i IV-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit të KK Pejë, i mbajtur me datë: 16. Maj 2024, me fillim në orën 13:00 h.

Takimi u mbajt në Zyren e KPF-ca të KK. Pejë.

Takimin e hapi dhe e kryesoi, kryesuesja znj. Valbona Avdijaj.

Kryesuesja, fillimisht konstatoi se në takim prezentojnë të 6 (gjashtë) nga 7 (shtatë) anëtarët e Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Ambientit, mungon me arsye z. Adnan Daciq.

Pos anëtarëve të KKMM. Prezentojn: znj.Edonjeta Berisha, drejtoresh e Drejtorisë së Inspeksionit, z.Miftar Shala, Insektor i Mjedisit të Komunës së Pejës, dhe z. Agron Bobi, përfaqësues i Agjencionit të pyjeve Pejë.

Pas konstatimit të kuorumit për mbajtjen e takimit, kryesuesja znj. Valbone Avdijaja, hapi takimin e KKMM. dhe për këtë takim propozoi dhe nga të pranishmit njëzërit pa vërëjtje, u miratu ky

### **REND DITE :**

- 1) Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshilëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesat.**
- 2) Shqyrtimi i Procesverbalit nga takimi i III- rë i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, mbajtur me datë:17. prill 2024.**
- 3) Shqyrtimi gjendjes së mjedisit në Komunën e Pejes,dhe parandalimi i dukurive negative në këtë drejtim.**

- 4) Gjendja e pyjeve në Komunën e Pejës, dhe masat që duhet ndërmarë në parandalimin e dukurive negative.
- 5) Çështje të ngritur në mbledhje nga udhëheqësi apo anëtarët.

## I.

**Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të Komitetit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit dhe mungesa.**

Në këtë takim prezentojn 6 (gjashtë) nga 7 (shat) anëtarët e KKMM-it, mungon me arsye: z. Senad Daciq.

## II.

**Shqyrtimi i Procesvërbalit nga takimi i III-të i rregullt i Komitetit Konsultativ për Mbrojtjen e Mjedisit, i mbajtur me datë: 17. Prill 2024.**

Procesvërbali u miratua njëzërit pa vërejtje.

## III.

**Shqyrtimi gjendjes së mjedisit në Komunën e Pejës, dhe parandalimi i dukurive negative në këtë drejtim.**

Në diskutim muarrën pjesë:

Znj. Edonjeta Berisha, informoi në pika të shkurta lidhur me drejtorin e inspektionit, duke theksuar se në kuadër të kësaj drejtorie funksionon Divizioni i Ambientit, në kuadër të të cilit veprojnë 3 Inspektor. Aj theksoi se gjendja në ambient nuk është e kënaqshme dhe se duhet vepruar më më përkushtim në këtë drejtim – sektor me përforcime të inspektionit dhe masave për përmirësimin e gjendjes dhe pengimin e dukurive negative. Inspektorati është aktivë në kontroll të gjendjes së ambientit 24/7 (gjatë gjithë javës), por prap gjendja nuk është e kënaqshme. Gjizhnjë nevojitet punë dhe angazhim më i madh në mënyrë që pozitivisht dhe me sukses të ndiokohet në përmirësim të gjendjes në ambient. Ndotja e ambientit bëhet kryesisht nga qytetarët, andaj duhet ngritur komunikimi me qytetar me qëllim të ngritjes dhe ndërgjegjësimin të tyre në mbrojtje dhe ruajtje të ambientit. Ajo theksoi se me iratimin e disa ligjeve, janë dhënë kompetenca në mundësi të intervenimit të inspektionit edhe në zonat tjera e sidomos në yonat e mbrojtura si ajo e Rugoves etj. Në fund drejtoresha ja kaloi fjalën Inspektorit të ambientit për informim më të detajuar, pasi që siq theksoi ajo aj është aktivë në teren gjatë gjithë kohës dhe ka informacione më konkrete lidhur me çështjen në fjalë.

Z. Myftar Shala, Inspektor i Ambientit, informoi në pika të shkurta për gjendjen e ambientit në Komunën e Pejës, duke potencuar problemet me të cilat ballafaqohet si dhe me masat dhe ndëshkimet që mirën për rastet e shkeljes dhe mospërfilljes së rregullave për mbrojtjen e

ambientit. Ai në përgjigje të pyetjes së shtruar nga ana kryesuese sëKKMM.ynj. Valbona, theksoi se inspektorati bënë mbikqyrje ndaj tërë territorit të Komunës së Pejës, duke përfshirë edhe yonat rurale.më tutje theksoi se kontrollat janë të përditshme dhe zhvillohen konform planit. Se planet janë ditore, javore dhe mujore. Por shpesh ndodh që inspektimi bëhet edhe konform kërkesave të qytetarëve dhe informacioneve mbi shkeljet që behën në teren, për të cilat miren masa adekuate dhe shqiptohen gjoba të cilat janë jo pak të ashpra,që ndërmirën dhe shqiptohen me qellim që veprimet negative të mos përsëriten dhe kryesit të ndëshkohen për veprimet e tyre. Gjobat janë diku rreth 1.000,00 € , por nëse gjoba pagohet brenda pesmbdhjet ditësh, ajo përgjysmohet. Por nese ndëshkimi nuk realizohet procedura zbatohet edhe përmes gjykatave etj.

Për ndërgjegjësimin dhe ngritjes dhe vetëdijësimin e opinjonit ne kemi mbajtur ligjerata dhe komunikime përmes fushata vetëdijësuese me nxënës dhe qytetarë në çka na ka ndihmuar edhe një organizatë joqeveritare nga Prishtina. Kryesisht ka qenë orientimi – fokusimi në zonat që janë zona turistike etj.Janë vendosur postera, shpresa, ndalesa, kontejnera dhe veprime të ndryshme me qellim të informimit dhe parandalimit të dukurive negative që veprojnë dhe ndikojnë negativisht dhe ndotin ambientin etj.

Z.Addhe Krasniqi, anëtarë i KKMM.-it, theksoi se: do ishte mirë që në kampanjat vetëdijësues të ceken edhe shifrat – për ndëshkime si në rastin e policisë (për hudhjene mbeturinave jashtë kontejnerëve, mbeturinave inerte, djegjave mbeturinave etj.) se edhe kjo mund të ndikojë në mënyrë preventive në mbrojtjen e ambientit dhe që qytetarët të jenë më të kujdesshëm.

Z. Ilir Thaçi, anëtarë i KKMM.-it, theksoi se para shqiptimit të masave të cilat janë tejet të ashpra, duhet ndërmarrë veprime preventive e ndërgjegjësusese në mënyrë që ndëshkimi të jetë masa e fundit. Duhet aplikuar një planë preventiv, ngase tani është periudha kur qytetarët bëjnë pastrime të kopshteve, fushave etj. dhe bëjnë ndezjen e mbeturinave që mund të ketë pasoja si në ndotjen e ajrit shtu edhe në rezimin e ambientit sidomos nëzonat periferik që mund të vije deri tek zjaret dhe pasoja tjera. Andaj, duhet vepruar paraprakisht që këto të mos ndodhin.

Znj. Sauda Pantinaj, anëtare KKMM-sit, shtroi gjithashtu pyetje se ka bashkëpunim me qytetar në drejtim të zbulimit të dukurive negative sidomos në hudhjen e mbeturinave dhe djegjen e tyre në raste të ndryshme etj.

Inspektori, dhe drejtoresha,në përgjigje lidhur me pyetjet e ngritura, theksoi se:mirren masat e duhura, qoft me paralajmërime, njoftime përmes medijave elektronike në bashkëpunim me policinë me kontrole të drejtëpërdrejta në terren dhe veprime të tjera sipas rastit.

Si problem u potencua numri i vogël i inspektorëve e sidomos mungesa e Inspektorit të Ndëtitimit, që është më së i nevojshëm në monitorim të ndërtimeve e sidomos të ndërtimeve pa leje në komunën e Pejës.

Në fund u konkludua se: gjendja e ambientit nuk është e kënaqshme, se ka probleme të dukshme, se Drejtoria për punë inspektuese dhe Inspektori i mjedisit duhet të marrë masa për inspektim sipas planifikimit në përmirësim të mëtutjeshëm të gjendjes së ambientit në komuneën e Pejës, për largimin e mbeturinave nga hapsirat publike ku ato paraqiten, të vendosën kontejner në hapsira ku ato mungonë dhe të shqiptoen denimet ndaj atyre që nuk i përfillin rregullat ligjore në fuqi, si dhe të rritet numri i inspektorëve e sidomos që DI të ketë Inspektor ndërtimi për monitorin të ndërtimeve pa leje etj.

Me këtë konkluzion u njoftua drejtëpërdrejt në takim drejtoresha e Drejtorisë së Inspektionit dhe Inspektori i Ambientit.

#### IV.

#### **Gjendja e pyjeve në Komunën e Pejës, dhe masat që duhet ndërmarë në parandalimin e dukurive negative.**

Z. Agron Bobi, përfaqësues i Agjencionit Pyjor, informo ianëtarët e KKMM-sit lidhur me gjendjen e pyjeve në komunën e Pejës, për ndryshimet e pasuara me formimin e Drejtorisë së Parkut Nacional, ndarjen regjionale, organizimin dhe menaxhimin e parkut etj. Ai pastaj informoi edhe për veprimet e mbrojtjes së pyjeve, mbrojtjen nga zjaret, prerjet e pyjeve, se me këto punë mirën profesionistët përkatës, se rruajtja e pyjeve bëhet gjatë 24 orëve me organiozime dhe plane të caktuara, bëhet edhe kontrolli i gjendjes së pyjeve dhe miren masa për eliminimin e viruseve apo sëmundjeve të drunjëve etj.

Kryesuesja znj. Valbona Avdijaj, potencoi se: në një takim të radhës do të zhvillohet një takim edhe me drejtorin e Agjencionit pyjor dhe atë të parkut Kombëtarë, për informim më konkret për menaxhimin e zonës së mbrojtur, në vendosjen e shportave dhe marrjen e masave tjera për mbrojtjen e ambientit, florës e faunës në zonat e mbrojtura etj.

#### V.

#### **Çështje të ngritur në mbledhje nga udheheqësi apo anëtarët.**

Mëqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës, e propozime tjera nuk pat, kryesuesja e takimit znj. Valbona Avdijaj, e shpalli të mbyllur këtë takim në orën 15,00 h.

**Pejë, dt.16. Maj 2024**

**Procesmbajtësi,  
Valdrine Gashi**

**Kryesuesja e KKMA.  
Valbona Avdijaj**